



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI BASHKIAK
GRAMSH

Nr. 209 / Prot
2

Gramsh më 03 / 02 / 2020

VENDIM
Nr. 02 Date 29 / 01 / 2020

MBI

KRITERET E PËRDORIMIT TË FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN
EKONOMIKE DERI NË 6%.

Keshilli Bashkiak ne mbledhjen e dates ___ / ___ / 2020, pasi mori ne shqyrtim Relacionin e Drejtorise Juridike, Burimeve Njerezore dhe Mbrojtjes Sociale ,Sektori Mbrojtjes Sociale “ Kriteret e perdorimit te fondit te kushtezuar per bllok ndihmen ekonomike deri ne 6%” mbeshtetur ne Ligjin Nr 57 dt 18.07.2019 “Per Asistencen Sociale ne Republiken e Shqiperise, Neni 21; VKM Nr.597 date 04.09.2019 si dhe ne Ligjin Nr. 139/2015 date 17.12.2015 “Per veteqeverisjen vendore” neni 8, pika 2; neni 9 , pika 1.1/a dhe 1.1/b si dhe neni 54 pika (k) dhe (n);

VENDOSI:

1. Te miratojë kriteret mbi përdorimin të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% si me poshte:
 - Te jene familje me kryefamiljare gra.
 - Te jene familje ne gjendje te dobet ekonomike.
 - Te jene familje me shume anëtare .
 - Te jene familje me femijë jetim ne kujdestari .
 - Te jene familje me probleme sociale.
2. Per familjet qe do te trajtohen me ndihme ekonomike duhet te jete kryer paraprakisht vlersimi social ekonomik ne familje nga administratori shoqeror sipas formularit tip te verifikimit dhe qe ruhet ne dosjen e deokumentave te aplikantit prane njesise vendore.
3. -Nuk mund te perfitojne ne baze te Vendimit 597 date 04.09.2019, familjet te cilat nuk kane aplikuar per ndihme ekonomike nepermjet Regjistrimit Elektronik Kombetar, familjet qe trajtohen me ndihme ekonomike , si dhe familjet qe jane perjashtuar nga sistemi per deklarime te rreme.
- 4-Per Zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Sektori I Mireqenies Dhe Kujdesit Social, Bashkia Gramsh.
Ky vendim hyne ne fuqi 10 dite pas shpalljes

Sekretari Keshillit
Endri Mema

Kryetari Keshillit
Greta Lena

Konc .E.Mema
Konfirmoi:
Miratoi:
Dosja _____
Afati _____

